### 2. TAKSA E QARKULLIMIT TE AUTOMJETEVE TE HUAJA

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët e doganave në pikat e kalimit kufitar. Personat

22 04	Verë dhe verërat e gazuara, shampanjë, musht rrushi - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi <= 1 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 1 000 hektolitër/vit	20 lekë /litri 35 lekë /litri
22 08	- nga prodhues vendas e të huaj, me sasi <=20 000 hektolitër/vit. - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi>20 000 hektolitër/vit Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit deri në 12 për qind	150 lekë /litri 200 lekë /litri 70 lekë /litri
22 08 20 29	Raki	100 lekë /litri
IV	DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ	
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 240 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	40 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg
V	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
27 10 11 41 27 19 11 45 27 10 11 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013gr/litër - Me më pak se 95 oktan - Me 95-98 oktan - Me 98 e më shumë oktan	37 lekë /litri
27 10 11 51 27 10 11 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër - Me më pak se 98 oktan - Me 98 e më shumë oktan	50 lekë /litri
27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/ kg
27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte dhe vajra të tjera	1 lek/kg
VI	ARTIKUJ KOZMETIKË, PARFUMERI DHE TUALETI	

**TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI**

E ardhura e tatueshme	Përqindje	
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	
0	10 000	0 për qind
10 001 +	30 000	+ 10 për qind të shumës mbi 10 000 lekë
30 001 +	Më tepër	10 për qind të shumës mbi 0 lekë

**AKCIZA**

Mallrat kryesore të tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë, janë si në tabelën e mëposhtme.

Kodi NK	PËRSHKRIMI	SHKALLA TATIMORE
I	KAFE	
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	50 lekë/kg
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	100 lekë/kg
II	LËNGJE FRUTASH, UJË DHE PIJE FRESKUESE	
20 09	Lëngje frutash dhe perimesh të pafermentuara, pa shtesa alkoolike, që përmbajnë ose jo lëndë ëmbëlsuese	2 lekë/litri
22 02	Ujërat minerale ose të gazuara, me ëmbëlsues ose aromatizues shtesë, pijet freskuese joalkoolike, përjashtim lëngjet e frutave	2 lekë/litri
III	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
22 03	Birrë e bërë nga malto	30 lekë/litri
	- nga prodhues vendas e të huaj me sasi ≤ 200 000 hektolitër/vit	
	- Nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 200 000 hektolitër/vit	40 lekë/litri

b. për të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kufiri minimal i regjistrimit është 8 milion lekë (për vit kalendarik) ose ndonjë shumë tjetër e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave në bazë të pikes 5 të këtij neni. Te gjithë personat juridike/fizike të cilet kane aktivitet eksporti ose importi jane te detyruar te regjistrohen per qellim pagimin e TVSH-se.

Janë të detyruar të regjistrohen gjithashtu edhe çdo subjekt tjetër si individët, organet e pushtetit qendror e lokal, organizatat shoqërore, politike, ndërkombëtare, misionet diplomatike, etj. që kryejnë aktivitetet import-eksporti, pavarësisht nga qarkullimi. Për çdo subjekt që kryen import-eksporte veprimet doganore bëhen vetëm pasi ai të ketë paraqitur origjinalin ose kopjen e noterizuar të Certifikatës së Numrit të Identifikimit për Personin e Tatueshëm (NIPT). Xhiro totale perllogaritet ne baze te cmimit total te paguar nga bleresi, duke perfshire edhe pagesat e taksave dhe denimeve (gjobave). TVSH zbatohet në masën 20 për qind, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.

Janë te perjashtuar nga nga pagesa e TVSH-se:

- Furnizimi i shërbimeve financiare.
- Furnizimet e arit, bankënotave a monedhave për Bankën e Shqipërisë.
- Furnizimi i pullave të postës për përdorim për shërbime postare ose pulla të ngjashme.
- Furnizimi i bërë nga një organizatë jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar është një furnizim i përjashtuar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 24 etj.

### Tatimi ne Burim:

Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jo-fitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjisllacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë:

Interesat	10%
Ndarjet e fitimit	10%
Pagesa per sherbime teknike, sherbimet e manaxhimit, sherbimet financiare etj	10%
Pagesat per qerate	10%
Dividentet	10%
Pagesat per te drejtat e autorit dhe pronesise intelektuale, etj	10%

### Tatimi mbi te Ardhurat Personale:

Te gjithë individet, rezidente ne Shqiperi tatoeshen per te gjithë te ardhurat e gjeneruara kudo ne bote, ndersa jo-rezidentet tatoeshen vetem per te ardhurat e gjeneruara brenda kufirit te territorit shqiptar.

### Legjislacioni Tatimor:

Regjimi i tatimeve dhe tarifave ne Republiken e Shqiperise konsiston ne nje pakete ligjesh, direktivash, rregulloresh, marreveshtje tatimore me vendet e tjera, te cilat japin nje pasqyre te plote te te gjitha llojeve, niveleve, perlllogaritjeve, procedurave si dhe metodikat dhe format e kontrollit tatimor te taksave, te perfshira ne sistemin tatimor shqiptar.

### Niveli i Taksave:

Personat juridike/fizike ne Republiken e Shqiperise jane subjekt te taksave te meposhtme:

Taksa	Norma e Taksës
Tatimi mbi Fitimin	10 % Nga 01.01.2008
Tatimi mbi te ardhurat personale	10 %
Tatimi mbi Burimin	10 %
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	20%

### Tatimi mbi Fitimin:

Te gjitha kompanite (te huaja ose jo) te cilat jane te rregjistruara ne regjistrin tregetar dhe paguajne TVSH-ne jane subjekt i tatimit mbi fitimin. Tatimpaguesit rezidente taten vetem per ardhurat te cilat i gjenerojne ne territorin e Republikës së Shqiperise.

Nje person juridik konsiderohet rezident ne Shqiperi ne qofte se:

- ka nje vendndodhje te perhershme (zyrat qendrore) ne Republiken e Shqiperise
- ka qendren efektive te menazhimit te biznesit ne Republiken e Shqiperise.

Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin aktualisht është 10 %, ndërsa para 1 janar 2008 ka qene 20%. Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuara nga ky ligj.

Dokumenti i përdorur si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është: fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përpiluar dhe lëshuar, në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor.

### Tatimi mbi Vleren e Shtuar:

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet:

- për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

			6	278	
16	Girokaster	Girokaster	2	95	Girokaster 23.558
17		Tepelene	2	77	
18		Permet	2	97	
			6	269	
19	Korce	Korce	2	155	Korce 60.871
20		Devoll	1	44	
21		Kolonje	2	76	
22		Pogradec	1	72	
			6	347	
23	Kukes	Kukes	1	90	
24		Has	1	30	
25		Tropoje	3	68	
			5	188	
26	Lezhe	Lezhe	2	63	
27		Kurbin	3	28	
28		Midrite	4	80	
			9	171	
29	Shkoder	Shkoder	2	139	Shkoder 84.364
30		Malesi e Madhe	2	56	
31		Puke	2	75	
			6	270	
32	Tirane	Tirane	3	155	Tirane 432.652
33		Kavaje	2	65	Kavaje 29.724
34		Bashkia Tirane	1	0	
			6	220	
35	Vlore	Vlore	4	99	Vlore 934.402
36		Sarande	2	62	Sarande 17.584
37		Delvine	1	38	
			7	199	
	<b>SHUMA</b>		74	2.962	

## TATIMET KRYESORE NE SISTEMIN TATIMOR SHQIPTAR

**1.1.3. Shteti.**

(Organet baze, Shpërndarja administrative, Sherbimet publike, Sistemi juridik Ekonomia dhe sistemi tatimor, Mbrojtja dhe sistemi publik.)

Shqipëria ndahet në 12 qarqe secili qark mesatarisht me 3-4 qytete. Nder qytetet me të mëdha mund të përmendin Tiranën, qe është dhe kryeqyteti i Shqipërisë, Durrësi, Vlora, Fieri, Shkodra, Gjirokastra, Berati, etj.

## ΔΙΟΙΚΗΤΙΚΗ ΔΙΑΙΡΕΣΗ ΤΗΣ ΑΛΒΑΝΙΑΣ

N/R	Qarku - rrethi	Qytete- zona	Numri / qyteteve	Numri fshatrave	Qytetet kryesore qendra të banuara dhe popullsia (2004)
1	Berat	Berat	2	122	Berat 45.448
2		Kucove	1	17	
3		Skrapar	2	103	
			5	242	
4	Diber	Diber	1	141	
5		Mat	3	76	
6		Bulqize	2	62	
			6	279	
7	Durrës	Durrës	4	61	Durrës 139.979
8		krujë	2	43	
			6	104	
9	Elbasan	Elbasan	2	176	Elbasan 98.145
10		Pegin	1	49	
11		Gramsh	1	95	
12		librazhd	2	75	
			6	395	
13	Fier	Fier	3	117	
14		Mallakaster	1	40	
15		Lushnje	2	121	Lushnje 37.892

është 135 km, ndërkohë që vetëm 72 km e ndajnë nga Italia dhe 77 milje nga Greqia. Pozicioni që ka Vlora garanton një lëvizje masive të turistëve vendas dhe të huaj. Gjiri i Vlorës dallohet për resurset e shumta natyrore, për biodiversitetin e pasur dhe koridoret ekologjike. Është ndër zonat me potencialin turistik më të lartë të vendit, gjë që lidhet me daljen direkte në det, me pasuritë e shumtanatyrore, klimaterike, ujore, arkeolo-gjike, historike, kulturore, njerëzore dhe ekonomike. Qyteti i Vlorës shtrihet ndërmjet Ujit të Ftohtë dhe Zvërnecit.

Rrafshi mbi të cilin ngrihet qyteti i Vlorës ka lartësi nga 6 m deri në 76 m mbi nivelin e detit dhe përfaqëson një nivel bazë kontinental, ende aktiv.

Ndërsa gjatësia e përgjithshme e vijës bregdetare është 90 km, nga grykëderdhja e Vjosës deri në Karaburun, e cila është shpallur nga Këshilli i Ministrave zonë me përparësi për zhvillimin e turizmit.

Aktualisht, qyteti i Vlorës vazhdon të zgjerohet në të gjitha drejtimet e veçanërisht drejt Bregut të Detit, sidomos drejt Ujit të Ftohtë dhe Jonufrës.

## KORÇA

Korça është një qytet në Shqipërinë jugore. Korça është edhe qendra e prefekturës me të njëjtin emër. Është një nga qytetet më të mëdha të vendit me rreth 85.000 banorë të regjistruar, por me 70.000 rezidentë.

Ekonomia e qytetit të Korçës i ka themelet e saj në zhvillimin bujqësor, por nuk mund të lihen pa përmendur bizneset e mëdha të qytetit të cilat përfshijnë kryesisht sektorin e ndërtimit civil dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit, sektorin ushqimor dhe atë të shërbimeve. Edhe pse Korça ofron mundësi të mira për zhvillimin e turizmit, ngelet akoma shumë për të bërë në këtë drejtim.

Radio në Shqip	Televizione në Shqip	Agjensi lajmesh
ALSAT	Radio "Top Albania"	Βρετανικό Πρακτορείο ειδήσεων (BBC)
TV ARBERIA	Radio "+2"	Associated Press
BBF TV	Radio "Deutsche Welle"	Γαλλικό Πρακτορείο ειδήσεων
DIGITALB	Radio "Italia"	ALNA (Albania News Agency)
KLAN TV	Radio "BBC World Service"	ATSH
KTV	Television "TV5"	Η φωνή της Αμερικής
MY MUSIC	Television "RAI 1"	Reuters
NEWS 24	Radio "RFI"	Deutsche welle
ORA NEWS	Radio "World Family"	TIR - FA
RTK		Albania Daily News
RTV 21		
SUPERSONIC TV		
TVSH		
TOP CHANNEL		
VIZION PLUS		
+ 64 televizione lokale	+ 35 radio lokale	

universitet publik "Universitetin e Luigj Gurakuqit".

### **FIER**

Fieri është një qytet i vendosur në jugperëndim të Shqipërisë. Qyteti i lashtë Corinthian i Apollonisë ndodhet vetëm 8 km larg. Është një qender e rëndësishme industriale, shtrihet pranë lumit të Gjanices dhe Semanit. Me qytezen e vogël të Patosit që ndodhet vetëm pak minuta larg është qendra e industrisë së naftës, bitumit, dhe lendeve kimike. Shumë rrugë që përhapen nga qendra të udhëheqin drejt Vlores në derëtim të jugut (35 km) dhe Patosit në lindje (8 km).

### **BERAT**

Berat është një qytet i cili është përfshirë në listën e trashëgimisë botërore në Korrik të vitit 2008. Shtrihet në të djathtë të lumit Osum, në një distancë të shkurtër në bashkimin e këtij lumi me lumin Molisht. Qyteti është i njohur për arkitekturën e tij historike dhe bukurinë e tij i njohur si qyteti i 1000 ditareve, për shkak të ditareve të shumta të shtëpive të vjetra. Të njëjten pamje mund ta shijosh në Gjirokaster dhe në Catanzaro (Itali) ku dikur ka jetuar një minoritet i vogël shqiptarësh. Është një zone mjaft e mirembajtur me rrugë të pastra, me shtëpi turke dhe kisha Ortodokse.

### **GJIROKASTER**

Qyteti është krijuar diku nga shekulli i 12 rreth një fortëse mbi një kodër. Aktualisht, Gjirokastra e ruan të paprekur skemën e saj urbanistike. Ajo përbëhet nga disa lagje të ndërtuara mbi një terren të aksidentuar, dhe që rrethojnë kalanë. Çdo shtëpi ka karakteristika të vecanta që lidhen me terrenin mbi të cilin ato janë ndërtuar. Sipas kategorive, në qytet dallohen kalaja, pazari, ndërtimet e kultit dhe shtëpitë e banimit.

Gjirokastra është një qender mjaft e rëndësishme komerciale me zhvillim të disa industrive, ku dallohet industria ushqimore, e lekures dhe tekstilëve

### **SARANDA**

Rrethi i Sarandës shtrihet në skajin me jugor të Shqipërisë me një sipërfaqe 732 km<sup>2</sup>. Saranda kufizohet me Delvinën, Vlorën dhe Gjirokasterin dhe lidhet me Greqinë përmes kufirit tokësor dhe detar. Rajoni jugor në teresi dhe zona përreth Sarandës specifikisht dallohet për diversitetin dhe pasurinë e habitateve. Saranda shtrihet midis kepit të Paladhës në veri-perëndim në një gjatësi 7.5 km e gjeresi maksimale rreth 1 km. Shtrihet në një gjë përgjithësisht të thellë, të pastër, me një ngjyrë karakteristike blu të thellë, me breg të lartë e shkëmbor dhe me një peisazh ujor që të kujton platene e në teatri gjigand natyror.

Qyteti shtrihet në një sipërfaqe prej 750 ha përgjatë një vijë bregdetare 7.5 km, buze detit Jon dhe rreth 1 km në thellësi. Konsiderohet si "qyteti i diellit" mbasi mesatarisht në vit ka 280-300 ditë me diell. Ka klimë mesdhetare. Temperatura mesatare arrin në 17-18 °C, në dimër luhet mesatarisht nga 10-12 °C dhe në verë nga 26- 28 °C.

### **VLORA**

Rrallë qytete në botë mund të kenë një pozicion kaq të volitshëm gjeostrategjik siç e ka Vlorën, e cila lidhet me daljen e saj të menjëherëshme në det dhe mbështetjen në vargmalet në lindje.

Pararoja përëndimore e qytetit është ishulli i Sazanit dhe gadishulli i Karaburunit me të cilët Vlorën mban "çelsat" e ngushticës së Otrantos. Vlorë është qytet i lashtë dhe porti jugor i Adriatikut. Sipas regjistrimit të vitit 2003 popullsia e Vlorës është mbi 124.000 banorë. Gjiri i Vlorës është i cekët ku thellësia shkon në 5 m pas 1 km larg bregut dhe 10 m pas 2 km larg bregut. Vlorë ka një pozicion të favorshëm, në kryqëzimin e rrugëve tokësore, detare dhe ajrore në të gjithë rajonin. Distanca nga kryeqyteti i vendit, Tirana,

Sherbimi Kombëtar i Transfuzionit është i përbërë nga 29 banka gjaku, 3 banka gjaku në Tiranë dhe 26 në rrethet.

### **Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Femijeve Tiranë:**

QKMZHRF Tiranë është ngritur si Qendër Kombëtare, Diagnostikuese, Trajtuese e Trainuese në vitin 2000, mbi bazën e spitalit distrofik Tiranë.

Misioni saj është përmirësimi i cilësive të jetës së femijeve me nevojë të vecanta, si dhe mbështetja e familjeve të tyre, për të pasur partnerë ato në rrugën e gjatë të rehabilitimit, kujdesit dhe edukimit të këtyre femijeve.

### **Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Biomjekësore:**

Qëllimi i saj është profilaksia dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore me qëllim që pajisjet mjekësore të kombinuar me personelin e institucioneve shëndetësore (mjeke, specialiste, infermiere) t'i shërbejnë sa më mirë pacientëve, duke rritur cilësinë në shërbimin ndaj tyre.

### **TIRANA**

Qyteti i Tiranës kufizohet në veri nga Kodër-Kamëz me lartësi 112 m mbi nivelin e detit; në jug nga Selita me lartësi 303 m mbi nivelin e detit; në perëndim nga Universiteti Bujqësor dhe në lindje nga Kodra e Sullit me lartësi 418 m mbi nivelin e detit.

Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Sasia mesatare e reshjeve është 1,297 mm. Tiranë përkrahë nga 2 lumenj kryesorë: Lumi i Lanës (nga Ish Autotraktorët tek Rezervati i Peshkut) me gjatësi 15.3 km dhe Lumi i Tiranës (nga shkalla e Tujanit tek Universiteti Bujqësor) me gjatësi 10.25 km. Në Tiranë ndodhen 4 liqene: Liqeni i Tiranës, Liqeni i Kodër-Kamëz, Liqeni i Farkës dhe Liqeni i Tufinës.

Tiranë është qendra më e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për tu përmendur janë industria e lehtë dhe ushqimore si dhe industria ndërtimore, por edhe industria e ndërtimit të makinerive apo ajo e tekstileve dhe e përpunimit të qelqit Shumica e popullsisë janë sot të punësuar në sektorin e tregëtisë dhe atë të ndërtimit, në sektorin e shërbimeve publike, atë turistik dhe si punonjës të shtetit.

### **DURRES**

Durresi është qyteti i dytë më i madh në vend, është më i lashtë dhe një nga qytetet më të rëndësishme në aspektin ekonomik. Ka një popullsi rreth 114000 banorë të vlerësuar në vitin 2003. Në vitin 2007 është hapur universiteti i parë publik në këtë qytet i quajtur "Universiteti i Aleksander Moisiut". Për shkak të pozitës gjeografike është një pikë lidhëse e rëndësishme me Evropën Perëndimore edhe për shkak të portit që është afër me portet italiane, vecanërisht me Barin. Aty është vendosur një punishte për riparimin e anijeve, fabrika prodhimi, për prodhimin e lekures, materialeve plastike dhe cigares. Gjithashtu prodhohet edhe verë dhe një varietete e prodhimeve ushqimore.

### **SHKODER**

Shkoder është një qytet i vendosur në Liqenin e Shkodrës në veriperëndim të Shqipërisë. Është një nga qytetet më të vjetra dhe historike të vendit, dhe një qendër ekonomike dhe kulturore mjaft e rëndësishme. Ka një popullsi rreth 200000 banorë me gjithë rrethinat të vlerësuar në vitin 2008. Është një qendër e rëndësishme industriale, aty prodhohen pjesë mekanike dhe elektrike, dhe prodhime tekstile dhe prodhime ushqimore. Ka një

Inxhinierise Biomjekesore dhe Qendra Kombetare e Kontrollit te Barnave.

Me perjashtim te Tiranes ku ne kuadrin e nje projekti pilot eshte riorganizuar sherbimi shendetesor paresor dhe eshte krijuar ASHR-ja, ne çdo distrikt funksionon nje DSHP-Drejtoria e Shendetit Publik e cila duhet te koordinoje te gjitha sherbimet shendetesore te rrethit. Ne 12 rrethet e medha (qendra te rajoneve) krahas DSHP-ve, funksionojne si drejtori te veçanta Drejtoria Spitalore dhe Drejtoria e Kujdesit Shendetesor Paresor. Ky organizim do te rishikohet me perfundimin e projektit pilot te ASHR-se duke synuar krijimin e autoriteteve rajonale qe do te koordinojne funksionimin e sherbimeve shendetesore ne rang rajoni.

### **Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor:**

Sigurimi Shendetesor ne Republiken e Shqiperise eshte institucionalizuar ne baze te Ligjit "Per Sigurimet Shendetesore ne Republiken e Shqiperise" (Nr. 7870), date 13.10.1994. Ai eshte i tipit Bismarkian. Skema e Sigurimeve Shendetesore ka hyre ne zbatim me 1 mars 1995 si nje mekanizem i rendesishem ne reformimin e sistemit shendetesor, si ne drejtim te menyres se financimit dhe rritjes se burimeve per kujdesin shendetesor, ashtu dhe te pempresimit te cilesise se sherbimeve.

### **Institucione nacionale:**

Sistemi shendetesor ne Shqiperi mbeshetet edhe nga nje sere institucionesh nacionale, te cilat varen direkt nga Ministria e Shendetesise.

### **Instituti i Shendetit Publik:**

Institucioni me i larte teknik ne fushen e shendetit publik eshte Instituti i Shendetit Publik i cili eshte nje institucion nacional nen varesine direkte te Ministrise se Shendetesise. Detyrat e tij perfshijne studimin dhe monitorimin e faktoreve te riskut, survejancen e semundjeve ngjitese, referencen laboratorike si edhe menaxhimin e programeve te vaksinimit. Zbatimi i mjaft programeve afatshkurtra me natyre studimore apo promovuese te shendetit eshte gjithashtu pjese e aktivitetit te tij. Instituti i Shendetit Publik luan edhe nje rol te rendesishem lidhur me trainimin ne fushen e shendetit publik.

### **Qendra Kombetare Kontrollit te Barnave:**

Qendra eshte institucioni pergjegjes per kontrollin e cdo veprimtari ne fushen farmaceutike. Ajo ushtron kontroll mbi a) veprimtarite e fabrikimin, mjediset dhe pajisjet e tij b) tregtimin me shumice dhe pakice si dhe kushtet e ruajtjes se barnave, c) lendet e para medikamentoze dhe lendet ndihmese ambalazhuese d) barnat e importura nga te gjitha subjektet e licensuara.

### **Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut:**

Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut ka si qellim sigurimin e gjakut dhe produkteve te tij per te plotesuar ne menyren me optimale kerkesat per transfuzione qe nevojiten per, trajtimin e personave te aksidentuar, pacienteve qe vuajne nga anemia e rende dhe kronike, pacienteve me kancer, pacienteve qe do t'u nshetrohen nderhyrjeve kirurgjikale, grave qe kane hemoragji te madhe gjate lindjes.

ngrit nga kolonistë Korinthos në vitin 627 paraK. Me gjithë shkatërimet nga tërmetet dhe mbulimi nga qyteti modern në qytetet janë zbuluar disa monumente ku më kryesorët janë Amfiteatri, Bukuroshja e Durrësit (mozaik) etj. Koleksionet e Muzeut Arkeologjik të qytetit janë më të pasura në Shqipëri. Bylisi ndidhet në kodrat afër fshatit Hekal. Monumentet më kryesore Teatri, Shetitorja dhe disa mozaikë bazilikash. Afër tij ndodhet dhe Bazilika e Ballshit e përmendur për mbishkrimet dhe epitafin me origjinë nga ai i quajtur (Epitafi i Glavinicës) 5 km larg Bylisit ndodhet dhe qyteti i lashtë Nikaja (afër fshatit Klos). Monumente kryesore këtu është një teatër. Oriku (Pashaliman) Ndodhet 20 km në jug të qytetit të Vlorës. Port i përmendur i lashtësisë dhe bazë detare shekullore. Përmendet nga historanë latinë për luftën e zhvilluar aty, ndërmjet Çezarit dhe Pompeut në vitin 43 paraK. Monumentet kryesore të këtij Parku arkeologjik janë: teatri, nekropoli, dhe kisha e Marmiroit. Kalaja e Kanines ne Vlore, I ka fillimet qysh ne gjysmen e pare te mijejcarit te fundit p.e.s. Amantia u themelua si qytet ne fund te shek V p.e.s. Antigonea ndodhet në fshatin Sofratikë Gjirokastër. Ka interesante teatrin fushor dhe nje partik me kollona të stilosur. Objektet e bronxit të zbuluara aty janë të famshme

### Feja:

Pjesa me e madhe e popullsisë i perket besimit musliman me rreth 65-70% te popullsisë dhe jane te ndare ne dy komunitete ate te Sunni Islam dhe Bektashi qe jane me liberal, qe perbejne 25 % te popullsisë muslimane. Kisha orthodokse e shqiperise dhe kisha katolike zene perkatesisht 20-25 % dhe 10 % te popullsisë. Popullsia mulsimane eshte e shperndare pothuajse ne te gjithë vendin ndersa ortodokset ne jug dhe katoliket ne veri, megjithese kjo ndarje nuk eshte fikse, sepse zonat urbane kane pergjithesisht popullsi te perzier.

### SISTEMI SHENDETESOR

Sistemi Shendetesor ne Shqiperi eshte kryesisht publik. Shteti siguron pjesen me te madhe te sherbimeve qe i ofrohen popullates si ne fushen e promocionit, parandalimit, diagnostikimit dhe kurimit. Sektori privat eshte akoma ne hapat e pare dhe mbulon pjesen me te madhe te sherbimit farmaceutik, sherbimit stomatologjik dhe disa klinika diagnostikuese specialitetesh te cilat jane perqendruar kryesisht ne Tirane.

Ne sektorin publik rolin e liderit e luan Ministria e Shendetesise e cila eshte hartuese dhe pergjegjese per politikat dhe strategjite e sistemit shendetesor, per rregullimin e tij si dhe per koordinimin e te gjithe aktoreve brenda dhe jashte sistemit.

Sherbimi shendetesor diagnostikues dhe kurues eshte i organizuar ne tre nivele: sherbimi paresor, sherbimi spitalor dytesor, dhe spitalor terciar.

Sherbimet e shendetit publik dhe promocionit ofrohen ne kuadrin e shendetit paresor dhe mbeshteten dhe mbikqyren nga ISHP.

Krahas ketyre ofrojne sherbimet e tyre edhe nje sere institucioneve nacionale si Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut, Qendra Kombetare e Mirerritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit te Femijes, Klinika Stomatologjike Universitare, etj.

Ne mbeshtetje te institucioneve shendetesore funksionojne edhe Qendra Kombetare e

është koha e ndërrimit të shumë qeverive. Dy figura, që spikatën në politiken shqiptare më pas ishin prifti ortodoks Fan Noli. Udhëheqësit e Revolucionit Borgjes të vitit 1924 dhe Ahmet Zogu, i shpallur mbret në vitin 1938. Pas pushtimit fashist më shtatë prill 1939 shqiptarët u reshtuan në lëvizjen antifashiste botërore deri në çlirimin e vendit më 29 Nëntor 1944. Për 55 vjet Shqipëria nën udhëheqjen e Enver Hoxhës do të bënte pjesë në kampin socialist.

### **Renia e diktatures:**

Në vitin 1990 Shqipëria si shume vende të tjera të Lindjes u bë pjesë e ndërrimit të sistemit komunist, i cili u zëvendësua me sistemin pluralist. Ishte përpjekja e shumë Intelektualeve shqiptare si: Prof. Dr Sali Berisha, Gramoz Pashko, Azem Hajdari etj mbështetur nga të gjitha shtresat e popullsisë që mundësuan ndërrimin e sistemit komunist. Sot Shqipëria është një vend demokratik që synon të futet në NATO, dhe është shume pranë futjes në Bashkimin Europian me të drejta të plota, pas firmosjes së marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit në 12 qershor nga kryeministri aktual i shqiptarëve Dr. Sali Berisha.

### **Monumente Kulturore**

#### **Pershkrimi:**

Shqipëria është një vend me kulturë të lashtë. Ilirët dhe pasardhësit e tyre arbërit dhe shqiptarët për tu mbrojtur ngritën keshjtellat dhe farkëtuan armët e tyre. Në kohë paqeje mjeshtërit zbukuronin qytetet, zejtarët punonin stoli të ndryshme, artistët skalitnin drurin dhe mermerin dhe poçarët prodhonin enë me gjithfarë formash. Udhëtoni nëpër Shqipëri dhe do të çuditeni se pranë ndërtimeve modeste të duket silueta e një kalaje madhështore, pranë një ure moderne të dalloni urat me harqe të lashtësisë. Hyni në muzetë edhe në ato të qyteteve të vogla dhe do të gjeni të mbushura me skulptura, kolona të gdhendura me mjeshtëri dhe objekte të tjera arkeologjike. Shkoni në pazaret Shqiptare dhe do të befasoni me bizhuteritë dhe veshjet fisnike tradicionale nëfilligran ose të qëndisur me fije argjendi dhe ari. Kjo është Shqipëria.

### **Monumentet e lashta**

Gërmadhat e kalave dhe fortesave ndodhen në vise të ndryshme, disa të tjera përfaqësojnë qytete të tëra Muze dhe parqe arkeologjike si qyteti i Shkodrës (Skodra kryeqyteti i lashtë i Ilirëve) me Rozafën dhe legjendën e saj të murrimit, tërheq mjaft vizitorë.

Kjo legjendë përfaqëson përpjekjen mijëvjeçare të shqiptarëve për të ndërtuar. Berati "qyteti i një mbi një dritareve" është shpallur në mbrojtje të UNESCO. Në këtë mbrojtje është dhe parku arkeologjik i Butrintit. Gjirokastra qyteti i gurtë me kalanë e saj si një kryqëzor në hapësirë dhe ndërtime imponante shprehin fisnikëri. Festivali folklorik që organizohet aty e gjallëron atë. Këtë vit në Shqipëri me qëllim zhvillimin e turizmit u hapën 6 parqe të reja arkeologjike si: Parku i Orikut, i Apollonisë, i Bylisit, i Amantias, Lisit dhe Shkodrës. Në mjaft prej tyre vitet e fundit po bëhen gërmime arkeologjike nga shqiptarë dhe të huaj.

Apollonia e gërmuar që para çlirimit nga arkeologu i famshëm francez Leon Rej vazhdon të studjohet nga institute francez e arkeologjisë. Nga monumentet më të rëndësishme të Apollonisë janë: ndërtesa e Aganotetëve e rikonstruktuar, Fontana, Teatri, vilat romake me mozaikë si dhe kisha e Shën Mërisë. Ky qytet i madh dhe hijerëndë siç e kanë quajtur me të drejtë shkrimtarët e lashtë ka qënë një qendër kulture dhe arti me rëndësi të dorës së parë përderisa ka studiuar dhe Oktavian Augusti. Dyrahu-Epidamnus,(Durrësi) U

## 2. Ilirët dhe pushtimi romak:

Nga fundi i mijëvjeçarit të dytë pese zbulimet arkeologjike na bëjnë të njohur një element të ri etnik që ishin Ilirët paraardhësit tanë. Arti Ilir pasqyrohet qartë veçanërisht tek format e objekteve që shërbenin për të zbuluar trupin. Ilirët që i përkasin familjes së madhe indo-europiane kanë qënë një popull i ndarë në shumë fise të mëdha dhe të vogla. Disa prej të cilëve kanë qënë: Ardianët, Dardanët, Lobeatët, Enkelejt, Pirustet, Taulantët, Mollosët, Kaonët. Ndërtimet në periudhën e hekurit (mijëvjeçari I p.e.s) kanë qënë të shumta. Ndër qytetet dalloheshin Bylysi, Skodra, Antipatrea, Aulona, Dimali, Amantia, Foinike, Antigonea si dhe qytetet Koloni, Dyrriahu, Apollonia, Orikumi dhe Buthroti. Ilirët me lindjen e rendit skllavopronar krijuan shtetin e tyre. Që nga shekulli VII-te para K. formohet federata e taulantëve me bazile Galaurin, dhe bashkësia e Mollosëve. Nga fundi i shekullit V-te para K. shteti Ilir ishte konsoliduar, mbreti i parë ishte Sira kurse më vonë pushtetën e mori mbreti i famshëm Bardhyli. Rreth viteve 360 para K. ky i fundit dhe pasardhësi i tij Kliti u përballën me përpjekjet e FYROM të Filipit II-te për të pushtuar territore ilire. Ilirët janë dalluar gjithmonë për karakterin e tyre luftarak. Demosteni oratori më i shquar i Greqisë së lashtë është shprehur : për sa i përket Pajonëve dhe fiseve të tjera ilire duhet besuar se për ta është më e kënaqshme të jenë të pavarur dhe të lirë sesa të nënshtruar. Mbretëria më e suksesshme në jetën politike të kësaj periudhe ishte padyshim Mbretëria e Ardianëve (v 231-168 para K.) e cila bashkoi në pushtetin e vet të gjitha tokat Ilire të veriut. Ngjarje që kanë ngelur të pashlyeshme në histori kanë qënë tre luftat Iliro-Romake nën udhëheqjen e Agronit dhe mbretëreshës trime Teuta. Pas vitit 168 para K. me invazionin e ashpër të Paul Emilit Iliria ra nën sundimin romak. Shumë ngjarje dhe kryengritje kanë ndodhur në këtë periudhë ku Ilirët janë faktor i rëndësishëm. Në vitin 9të të erës sonë Batua në dardan do të trondiste gjithë perandorinë me kryengritjen e tij. Udhëheqës ushtarak të shquar kanë dalë nga gjiri i Ilirëve edhe më pas në periudhën Bizantine. Ata i kanë dhënë botës pesë perandorë si: Diokliciani, Anastasi (me origjinë nga Durrësi), Kostandini, Justin i dhe Justiniani. Ambasadori amerikan Xhorxh Uilliams në veprën e tij "Shqiptarët" thotë: "Historia e Shqipërisë i ngjan një liste të gjatë pushtimesh". Dhe me të vërtetë Gotet, Sllavët, Normandët do të zotëronin për një kohë të gjatë këtë vend.

## 3. Arberia dhe principatat:

Në Shqipëri u krijuan disa principata arbërore si Balshajve, Muzakajve, Ardianëve etj. Pas vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut (1468), i cili kishte zbrapsur turqit për 25 vjet Shqipëria ra nën sundimin osman për 450 vjet.

## 4. Rilindja kombetare dhe lufterrat boterore:

Fillimi i shekullit XIX-te përbën rilindjen kombëtare të Shqiptarëve. Lëvizjet e para janë kulturore dhe kanë të bëjnë me përhapjen e arsimit dhe kulturës por dhe me kërkesa autonomiste siç ishte rasti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 1878. Udhëheqës të shquar të kulturës, diplomacisë dhe lëvizjeve të armatosura kanë qënë Naum Veqilharxhi, Jeronim De Rada, vëllezërit Frashëri, Pashko Vasa, Konstadin Kristoforidhi etj. Në fillim të shek XX-te Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi dhe te tjerë do të ideonin dhe drejtonin përpjekjen për pavarësi, që do të kurorëzohet me ngritjen e flamurit dy krenar në qytetin e Vlorës më 28 Nëntor 1912. Qeveria e Ismail Qemalit me kryeqytet Vlorën do të qeveriste vendin për 14 muaj, pas kësaj, Shqipëria do të bëhej mbretëri me në krye Princin europian Vidi me kryeqytet Durrësin. Tirana u bë kryeqytet i vendit me 1920 pas luftes se I-rë Boterore. Kjo

## Popullsia dhe territori

Sip: 28.748 Km<sup>2</sup>, Popullsia: 3.1 Milion banore. Kryeqyteti: Tirana me rreth 800. 000 banore. Shqipëria nga ana gjeografike është një territor me shumë kontraste. Ka një larmi të pabesueshme të relievit, duke krijuar një mozaik mjedisor. Madheshtore ngrihen në territore të ndryshme male të larta të thepisura që kanë ndikuar në tiparte e banoreve ndoshta dhe të emrit të tyre. (Shqiptaret e kanë marrë emrin nga Shqiponja, që është dhe simboli i flamurit shqiptar). Nga vargmalet me imponante janë padyshim Alpet e Veriut me majen me të lartë Jezercen (2660m ). Mali me ilarte i Shqipërisë është Korabi (2754 m) i lartë dhe ndodhet në V. lindje të vendit. Vargmale të tjera janë Vargmali i Skenderbeut, Malesia Pike-Mirdite, dhe Vargmalet e Lures, ku ndodhen dhe disa liqene të mrekullueshme akullnajore. Në rajonet Jug-Lindore dhe Jugore, interesante janë Mali i Tomorit ose Baba Tomori sic permendet nga vendasit. Është një mal me majë të sheshtë prandaj është çilesuar si fron perëndije, për këtë me mijëra pelegrine shkojnë çdo vit atje për të bërë kurban perëndive. E njëjtat gjë ndodh dhe me Malin e Bardhë në rrethin e Vlores ku është ngritur një tempull nderimi. Me në jug ndodhen male të tjera si mali i Çikës mbi Akrokeraunë. Jo me kot e quajne atë Mali i Vetitimave (Çika në Shqipëri do të thotë Xixa). Në këtë vend mund të shikosh me të vërtetë pozicionin me tipik të kontrasteve Shqiptare Llogarane, ndërsa mund të besh ski në këtë vend për një orë mund të zbresesh në det për të nxirë nga rrezet e ngrohta të diellit. Malet janë simbol i shqiptareve: në krahinë të ndryshme kanë simbole Palisi, Shpati, Gramozi, Shrebeniku ose Dajti në Kryeqytetin tonë ku mund të shkohet me teleferik.

## Gjuha

Shqipja është një gjuhë indoevropiane që flitet në Shqipëri, Kosovë, FYROM dhe nga shqiptarët etnikë në pjesë të tjera të Ballkanit jugor. Gjuha shqipe flitet gjithashtu edhe përgjatë bregdetit lindor të Italisë dhe në Sicili, në jug të Greqisë si dhe në Gjermani, Suedi, Shtetet e Bashkuara, Kanada, Ukrainë dhe Belgjikë. Shqipja është një ndër gjuhët moderne që përfaqëson një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane.

## Historia

### 1. Lashtesia:

Shqipëria është një vend me një trashëgimi të pasur historike. Kerkimet arkeologjike të ndërtuara si nga studiues të huaj si Ugolini, etj ashtu edhe nga studiuesit tane kanë vertetur se trulli i banuar sot nga shqiptaret filloi të popullohej që në epokën e paleolitit, mbi 100 000 vjet më parë. Në Shqipëri vendbanime të kësaj kohe kanë qenë; Shpella e Gajtanit (Shkoder), vendbanimet në Malin e Dajtit dhe të Xares (Sarandë) etj. Njerezit primitivë jetonin në grupe të veçuara pranë shpellave të thata dhe të mbrojtura. Gjate periudhës së neolitit vendbanimet u shtuan ndjeshëm. Vetëm në zonën e Korçës janë gjetur 12 të tilla. Këto kanë qenë ndërtuar në vende të hapura, në luginë dhe pranë ujërave, lumëve dhe liqeneve. Tipik është vendbanimi i vendosur mbi shtylla druri i zbuluar në Maliq në vitin 1948 (vendbanim palaft), dhe shpellat e Velçës, pikturat shpellore të Lepenicës etj. Muzetë shqiptare kanë mjaft objekte guri e stralli dhe nga shpella të tjera si të Komrikut (Kolonjë), Spilesë (Himarë), etj. Një hov të mëtejshëm i dha zhvillimit ekonomik e kulturor në vendin tonë zbulimi dhe përpunimi i metaleve (periudha e bakrit dhe e bronzit). Objekte kryesore të kësaj kohe janë tumat si të Pazhokut, Matit, fshatit Vajzë (Vlorë) dhe Vodhinë (Gjirokastër).

21	LUSHNJE	144.351	4,7%	712	2,5%
22	MALESI M.	36.770	1,2%	555	1,9%
23	MALLAKASTER	39.881	1,3%	393	1,4%
24	MAT	61.906	2,0%	1.029	3,6%
25	MIRDITE	37.055	1,2%	867	3,0%
26	PEQIN	32.920	1,1%	109	0,4%
27	PERMET	25.837	0,8%	930	3,2%
28	POGRADEC	70.900	2,3%	725	2,5%
29	PUKE	34.454	1,1%	1.034	3,6%
30	SARANDE	35.235	1,1%	749	2,6%
31	SKRAPAR	29.874	1,0%	775	2,7%
32	SHKODER	185.794	6,0%	1.973	6,9%
33	TEPELENE	32.465	1,1%	817	2,8%
34	TIRANE	523.150	16,9%	1.238	4,3%
35	TROPOJE	28.154	0,9%	1.043	3,6%
36	VLORE	147.267	4,8%	1.609	5,6%
	<b>SHUMA</b>	3.087.159	100%	28.747	100%

### Popullsia

3,127,263 (viti 2004)

95% Shqiptare, 3% Greke dhe 2% të tjerë

Shkalla e rritjes së popullsisë

1,05% (2004)

Sipërfaqja e përgjithshme është 28.748 kilometra katrore. Kryeqyteti i saj është Tirana. Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 1094 km, nga te cilat 657 km - kufi tokësor, 316 km - kufi detar, 48 km - kufi lumor dhe 73 km - kufi liqenor. Në veri e verilindje ka 529 km vijë kufitare me Malin e Zi, Kosovën dhe ish republikën jugosllave të FYROM, ndërsa në jug e juglindje me Greqinë një vijë kufitare prej 271 km.

Shqipëria ka një pozitë të favorshme gjeografike, pasi gjendet në kryqëzimin e rrugeve më të shkurtëra që kalojnë nga Mesdheu perëndimor për në Ballkan e Azinë e Vogël dhe kontrollon kalimin përmes kanalit detar të Otrantos. Luginat e saj më të gjëra janë ato të lumenjve Drin, Shkumbin dhe Vjosë, që lehtësojnë, njëkohësisht, lidhjen e brendshme të Ballkanit me detin Adriatik dhe të Azisë së Vogël me viset e Mesdheut. Bregdeti i Adriatikut shtrihet nga gryka e Bunës deri në Kepin e Gjuhëzes. Në gjirin e Vlorës e në drejtim të jugut, bregdeti është i lartë, shkëmbor, ku dominon mali i Karaburunit. Gjiret kryesore të Shqipërisë janë: gjiri i Drinit, i Lalëzit, i Durrësit, i Karavastasë dhe i Vlorës, në hyrje të së cilës gjendet ishulli i Sazanit.

**1.1.2. Popullsia.**

(Historia, Feja, Kultura, Gjuha, Shoqeria, Sistemi Shendetesor, Qytetet Kryesore, Shtypi, Radio-televizioni, Agjensi lajmesh)

**Popullsia:**

Popullsia shqiptare eshte me moshe shume te re. Mbi 40 per qind e saj, si per meshkuj edhe per femra, i perket grup-moshes 0- 19 vjec, 50 per qind grup-moshes 20- 64 vjec dhe vetem 10 per qind jane mbi 65 vjec. Ne total popullsia eshte rreth 3,5 milione banore. Sipas te dhenave te PNUD-it (Janar 2000), 15 per qind e popullise shqiptare ndodhet aktualisht jashte territorit te Shqiperise.

POPULLSIA - RREGJISTRIM 2001					
No	RRETHET	POPULLSIA	% POP.	SIPERFAQE	% POP.
	1	2	3	4	3
1	BERAT	128.410	4,2%	939	3,3%
2	BULQIZE	42.985	1,4%	469	1,6%
3	DELVINE	10.859	0,4%	348	1,2%
4	DEVOLL	34.744	1,1%	429	1,5%
5	DIBER	86.144	2,8%	1.088	3,8%
6	DURRES	182.988	5,9%	433	1,5%
7	ELBASAN	224.974	7,3%	1.372	4,8%
8	FIER	200.154	6,5%	785	2,7%
9	GRAMSH	35.723	1,2%	695	2,4%
10	GJIROKASTER	55.991	1,8%	1.137	4,0%
11	HAS	19.842	0,6%	393	1,4%
12	KAVAJE	78.415	2,5%	414	1,4%
13	KOLONJE	17.179	0,6%	805	2,8%
14	KORCE	143.499	4,6%	1.752	6,1%
15	KRUJE	64.357	2,1%	333	1,2%
16	KUCOVE	35.571	1,2%	84	0,3%
17	KUKES	64.054	2,1%	938	3,3%
18	KURBIN	54.519	1,8%	273	0,9%
19	LEZHE	68.218	2,2%	479	1,7%
20	LIBRAZHD	72.520	2,3%	1.023	3,6%

ujëmbledhës të tyre shtrihet brenda territorit shqiptar. Këta lumenj shkarkojnë në detin Adriatik mesatarisht 1'308 m<sup>3</sup>/s (min. 649 dhe maks. 2'164 m<sup>3</sup>/s); moduli mesatar i rrjedhjes është 30,2 l/s . km<sup>2</sup>. Nga prurja e përgjithshme vjetore prej 42,25 miliardë m<sup>3</sup>, vetëm 12,8 miliardë u përkasin ujërave nëntokësore. Mesatarja vjetore e rreshjeve në territorin shqiptar është 1'430 mm/vit, por të shpërndara jo uniformisht përgjatë vitit: rreth 40% në dimër, 32% në pranverë, 17% në vjeshtë dhe vetëm 11% në verë.

Prej rreshjeve të çrregullta, lumenjtë janë të rrëmbyeshëm, gërryes (në pjesën lindore të vendit) dhe përgjithësisht formojnë shtrat të gjerë dhe të lakuar në Ultësirën Bregdetare Perëndimore. Lumenjtë kryesorë rrjedhin nga juglindja drejt veriperëndimit, me kah drejt perëndimit në deltat bregdetare. Përmbajtja minerale e ujërave është përgjithësisht e ulët, midis 150 dhe 500 mg/l, kryesisht si bikarbonate. Temperatura luhatet nga 3,5 në 8,9°C në dimër, dhe nga 17,8 në 24,6°C në verë. Gati gjithë lumenjtë shkarkojnë ujërat në detin Adriatik, në një zonë prej rreth 150 km.

### **Deti, liqenet, pyjet**

Shqipëria ka një vijë bregdetare rreth 400 km por dhe tre Liqene mjaft te pershtatshme per plazh si: Liqeni i Shkodres, Ohrit dhe Prespes si dhe shume lumenj te rrembyeshem (i vetmi lum i lundrueshem eshte Buna 44 km i gjate). Lagunat si ajo e Karavastase, Nartes e Butrintit jane ekosisteme me pasuri te paçmuara te faunes dhe te flores. Liqeni me i madh eshte ai i Shkodres me siperfaqe 368 km<sup>2</sup> kurse lumi me i gjate Drini me gjatesi me shume se 400 km. Lumenj te tjere jane Mati, Shkumbini, Semani, dhe Vjosa e cila buron qe nga malet e pindit ne Greqi.

Fushat dhe luginat jane nje burim i rendesishem i ekonomise se vendit. Ato krijojne dhe pisazhe te gjalla plot gjelberim. Ne vijen bregdetare ato krijojne ..... te pershtatshem ku jane ngritur porte te rrendesishme si Durresi, Vlora, Saranda, Shengjini etj, kurse prane luginave ndodhen qendra ekonomike si Elbasani, Fieri, Berati, Korça etj. Vendi yne eshte i pasur me pyje me shkurre mesdhetare dhe deri ne ato halore.

Ato jane mjediset e perhapjes se llojeve te shumta te botes shtazore ku vendin kryesor e zene shpendet por dhe ariu i murme, derri i eger, dhelpra, lepuri, kaprolli etj. Hapesira te veçanta me vlera biologjike e turistike jane shpallur zona te mbrojtura; te tilla jane: Parku i Prespes, Parku i Tomorrit, Parku i Dajtit, Parku i Thethit, Parku i Qafshatames, Bredhi i Hotoves (1300ha), Bredhi i Drenoves (1380ha), Parku i Divjakes, Parku i Lures, Parku i Llogarase, zonat e lagunave te Nartes, Orikumit, Butrintit etj. Disa prej ketyre kane lokale e ambiente per turizmin dimeror ose veror dhe jane mjaft te frekuentuara nga grupmosha te ndryshme.

### **Klima:**

Shqipëria ka një klimë mesdhetare. Per shkak te relievit te saj malor te thyer, klima ka nje larmi te madhe ne te gjithe vendin. Shqipëria karakterizohet me vere te thate dhe te nxehte, me dite me diell te shkelqyer, dhe pergjithesisht dimer te ftohte, te bute dhe me reshje te shumta. Zakonisht, harku kohor Qershor-Shtator karakterizohet prej nje kohe te nxehte me diell, ndersa Tetor-Maj, fresket/ftohte dhe lageshti.

## 1.1 Karakteristika te pergjithshme te vendit

### 1.1.1. Vendi

(Gjeografia, Relievi, Klima, Pyjet)

#### Pozita Gjeografike:

Shqipëria është një vend në Europën Juglindore, në perëndim të gadishullit të Ballkanit. Ajo ndodhet midis koordinatave gjeografike 39 gradë e 38' dhe 42 gradë e 39' të gjerësisë veriore dhe 19 gradë e 16' të gjerësisë lindore, në largësi pothuajse të barabartë nga Ekuadori dhe Poli i Veriut. Sipërfaqja e përgjithshme 28.748 kilometra katrorë. Kryeqyteti i saj është Tirana. Gjatesia e përgjithshme e vijes kufitare është 1094 km, nga të cilat 657 km - kufi tokësor, 316 km - kufi detar, 48 km - kufi lumor dhe 73 km - kufi liqenor

#### Relievi

Fushor (në Shqipërinë Perëndimore), Pllajor (në Shqipërinë Lindore Malor (në Shqipërinë Veriore dhe Qendrore); Maja më e lartë: Mali i Korabit (2,753m) Vija Bregdetare 362 kilometër

Relievi i Shqipërisë është kryesisht malor. Vargmalet e para alpine u formuan nga mbarimi i jurasikut, ndërsa gjatë erës kenozoike u shpejtua procesi malformues në tërësinë e Albanideve, që aktualisht përbëjnë tokën e nëntokën e Shqipërisë. Lartësia mesatare e relievit është 708 metra, ose 2 herë më e lartë se mesatarja e Evropës. Lartësitë më të mëdha gjenden në Alpet shqiptare dhe në malet e Lindjes (Korabi 2751 metra mbi nivelin e detit, përbën edhe majën më të lartë të Shqipërisë).

Fushat zene kryesisht pjesën perëndimore, përgjatë bregdetit Adriatik, por ka edhe në pjesë të tjera të vendit. Fushat më të larta janë ato të pellgut të Korçës, mbi 800 metra mbi nivelin e detit. Fushat gjenden kryesisht përgjatë lumenjve kryesore si: Vjosë, Devoll, Osum, Shkumbin, Erzen, Mat e Drin, ku gjenden, gjithashtu, edhe tokat bujqësore e qendra të mëdha banimi, si dhe përkohë nga rrugë të rëndësishme komunikimi. Territori i Shqipërisë ndahet në 4 krahina të mëdha natyrore (fiziko-gjeografike):

Alpet shqiptare  
Krahina malore qendrore  
Krahina malore jugore  
Ultesira bregdetare

**Plazhet kryesore janë:** Plazhi i Velipojes, i Tales, i Shengjinit, i Durrësit, i Divjakes, i Semanit, i Vlores, i Dhermiut, i Himares dhe ai i Sarandës.

**Kepat kryesore janë:** Kepi i Rodonit, i Bishtit të Palles dhe i Gjuhezes.

#### Lumenjte

Për shkak të veçorive morfologjike, Shqipëria është shumë e pasur në lumenj. Më shumë se 152 lumenj dhe përrenj, formojnë përfundimisht 8 lumenj të mëdhenj, që rrjedhin nga juglindja drejt veriperëndimit, kryesisht drejt bregdetit Adriatik. Rreth 65% e pellgut



## HYRJE

Ky udhëzues, u përpilua në përputhje me programin Interreg III: «Programi i fqinjësisë Greqi-Shqipëri», Aksi 2-Masa 2.1 dhe referohet në orientimin e shpejtë të afaristit të mundshëm për përgatitjen e shpejtë të tij, me qëllim që të zbulojë mundësitë investuese që ndoshta mund të ekzistojnë, si në mbarë Shqipërinë ashtu dhe në pjesën jugore të saj.

Enti i investimit është Dhoma Tregtare e Janinës, e cila mori përsipër këtë vepër në bashkëpunim me Dhomën Tregtare të Gjirokastrës.

Parimi në zgjedhjen e të dhënave ishte regjistrimi në thelb dhe i shpejtë i të dhënave për afaristin që ka ndërmend të përpiqet në një treg të ri, në tregun e Shqipërisë, duke respektuar kohën dhe mundësitë e tij.

Falenderojmë të dyja Dhomat e Tregtisë, të Janinës dhe të Gjirokastrës, për ndihmën e çmuar që na dhanë dhe urojmë që ky Udhëzues të jetë me përfitim për të dy vendet

- 4.1. Regjimi financues - Kreditë
  - 4.2. Përforcimet ekzistuese – sponsorizimet dhe stimulimet.
- Kapitulli 5.
- Gjetja dhe arsimimi i personelit:
- 5.1. Arsimi dhe shkenca.
  - 5.2. Arsimimi dhe përgatitja profesionale
  - 5.3. Nivelet e rrogave - Siguracionet shoqërore.

SHTOJCA A

Informacione të vlefshme.

SHTOJCA B

Rasti i Gjirokastrës.

SHTOJCA C

Ekspozitat tregtare.

SHTOJCA D

Dokumentacioni-Bibliografia.

UDHËZUESI I BIZNESIT NË SHQIPËRI  
TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrja

Kapitulli 1

Temat themelore:

1.1 Karakteristikat e përgjithshme të vendit:

1.1.1. Vendi.

(Gjeografia, Morfologjia, Pyjet, Klima)

1.1.2. Popullsia.

(Historia, Besimet, Kultura, Gjuha, Shoqëria, Shëndetsia, Qytetet e rëndësishme, Shtypi, Radio-Televizioni, Agjensitë e Shtypit)

1.1.3. Regjimi.

(Ndarja Administrativa-Shërbimet Publike, Sistemi Tatimor, Sistemi Ligjor)

1.2. Tregtia:

(Tregtia e Jashtme-Sektori Ekonomik i Jashtëm, Doganat dhe Taksat për Importin, Produktet e ndaluara nga Importi, Markat dhe Etiketat e detyrueshme)

1.3. Afarizmi

1.4. Turizmi

1.5. Infrastrukturat e Transportit:

(Transportet Rrugore, Portet, Transportet Ajrore, Postat)

1.6. Telekomunikacionet

1.7. Energjia.

1.8. Investimet:

(Legjislacioni përkatës, kadastra dhe kantieret, urbanistika dhe enti i banesave, bujqësia dhe peshkimi, mbrojtja e ambjentit, mbrojtja e konsumatorit, paraja dhe bankat)

Kapitulli 2.

2.1 Proçedura e themelimit të biznesit

2.2 Format ligjore të shoqërive vartëse dhe karakteristikat themelore të tyre:

2.2.1. Shoqëri e panjohur:

2.2.2. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar:

2.2.3. Shoqëritë aksionere, tregtare etj.:

Kapitulli 3.

Krijimi një plani të përkryer business plan.

Kapitulli 4.

Financimi i veprimtarive investuese:



Dhoma e Tregëtise Janine

## Guide tregëtare e Shqipërise

JANINE 2008



ME FINANCIMIN E GREQISE DHE KOMUNITETIT  
EVROPIAN



DHOMA E TREGËTISE JANINE

INTERREG III

